

KËRKESË
Nr.2011/7, datë 26.7.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Levan-Tepelenë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”” (sipërfaqet m²), si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 (objektet) për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur e çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Për pasuritë me pronarë të paidentifikuar apo të pakonfirmuar, të bëhet shënimi në kolonën përkatëse “I pakonfirmuar” dhe të sqarohet në tekstin e publikimit se personat që pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP-së, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Për objektin në proces legalizimi, të sqarohet në tekstin e publikimit, që pronari do të likuidohet për efekt shpronësimi pasi të përfundojë procesi i legalizimit dhe ai i regjistrimit pranë ZVRPP-së.

Për objektin për të cilin është bërë shënimi “Rikonfirmim”, sqarojnë se do të rikërkohet konfirmim pranë ZVRPP-së lidhur me titullin e pronësisë për këtë objekt.

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 96 454 259.67 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi